



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2021:295938

Datë: 02.02.2022

Numri i dokumentit: 02673486

**PPP.nr.58/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**, si përmbarimore me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike te kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimi me Energji Elektrike me seli ne Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr.5, ndërtesa Elektrokosova, kati VII, kundër debitorit Z. Gj. M. nga Fsh G. K-Istog, lidhur me pagesën e borxhit ne shumë prej 1,670.01 €, gjykata, duke vendosur sipas prapësimit te parashtruar nga debitori me datë 16.12.2021, kundër Urdhrit mbi lejimin e Përmbarimit, gjykata jashtë seancës me datë 02.02.2022, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit Z. Gj. M. nga Fsh G. K-Istog, ashtu që:

**II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri mbi lejimin e Përmbarimit P.nr.382/2021 i dt: 07.12.2021 për periudhën kohore 04.03.2014 e deri me 31.12.2019 në shumë prej 1,626.77 €, dhe **OBLIGOHET** debitori Z. Gj. M. nga Fsh G. K-Istog, qe kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimi me Energji Elektrike me seli ne Prishtinë, ne emër te borxhit për energjinë elektrike e harxhuar për periudhën kohore 01.01.2020 e gjerë me 06.11.2021, t'ia paguaj shumën prej 43.24 €, me kamatë ne lartësi prej 8%, nga data 07.12.2021, e deri ne pagesën definitive te detyrimit, te gjitha këto ne afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit nën kërcënim të përmbarimit te detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Kreditori, Kompania Kosovare për Furnizimi me Energji Elektrike me seli ne Prishtinë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit Z. Gj. M. nga Fsh G. K-Istog, për pagesën e borxhit ne emër te energjisë elektrike te harxhuar për periudhën kohore 04.03.2014 e gjerë me 06.11.2021, në shumë totale prej 1,670.01 €, me kamate prej 8% vjetore, si dhe shpenzimet e procedurës, te gjitha këto ne afat 7 ditor ne të kundërtën te behet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve te luajtshme

dhe te paluajtshme e mjetet e mbledhura ne shumen e kërkuar te derdhen ne llogari te kreditorit, te gjitha këto te specifikuar ne propozimin për përmbarim te dt. 07.12.2021.

Organi përmbarues me Urdhrin P.nr.328/2021 te dt: 07.12.2021, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit te kreditorit.

Debitori Z. Gj. M. nga Fsh G. K-Istog, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke e kontestuar ne tersi urdhrin përmbarimor për shkak te parashkrimit konform nenit 360 par.1 nen par.1.1 te LMD-së dhe nenit 71 par.1.4 te LPP-së, e po ashtu dokumenti me te cilin është lejuar përmbarimi nuk është i përshtatshëm për përmbarim dhe ne kundërshtim me nenin 27 par.1 te LPP-së, andaj kërkoj qe te aprovohet prapësimi si i bazuar, te refuzohet ne tersi propozimi dhe te përfundohet procedura përmbarimore.

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim duke e kundërshtuar prapësimin në tërësi si të pabazuar dhe të paargumentuar, pretendimet e debitorit se nuk janë dorëzuar faturat te debitori, nuk qëndrojnë për arsye se leximi i konsumatorëve bëhet në pjesën e tretë të muajit dhe aty ku është i vendosur njehsori, aty i lihet fatura në atë vend, propozimi për përmbarim është bërë për periudhën 04.03.2014 e deri më 06.11.2021, dhe ka bërë pagesa të kohëpaskohshme në vlera të ndryshme por nuk e ka përmbushur obligimin në tërësi e konform nenit 368 par.1 dhe 2 kemi ndërprerje të parashkrimit dhe nuk fare parashkrim të borxhit pasi qe faturat e vitit 2014 kanë filluar te parashkruhen ne vitin 2015 konform nenit 360 par.2 te LMD-së dhe asnjë herë nuk kemi pasur ankesa të parashtruara për kontestim te borxhit nga debitori. Me tutje kreditori shton se kërkesa për prapësim nuk është ne harmoni me nenin 69 te LPP-së, po ashtu për ta vërtetuar validitetin e kësaj përgjigje konform nenit 73 te LPP-së kërkojmë qe te hapet seancë publike.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe lidhur me pretendimet e debitorit kur thirret në atë dokumenti me te cilin është lejuar përmbarimi nuk është i përshtatshëm për përmbarim dhe ne kundërshtim me nenin 27 par.1 te LPP-së, andaj kërkoj qe te aprovohet prapësimi si i bazuar, te refuzohet ne tersi propozimi dhe te përfundohet procedura përmbarimore, të njëjtat pretendime refuzoj si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka iniciuar ne bazë të dokumentit te besueshëm e konform nenit 29 par.1.2 te LPP-së është dokument i përshtatshëm për përmbarim, po ashtu në shkresat e lendes gjendet transaksioni i konsumatorit ku ne mënyrë te qartë janë te cekura si fatura, referenca, nr. i konsumatorit, data, shuma e energjisë se shfrytëzuar.

Ndërsa sa i përket pretendimeve rreth parashkrimit gjykata gjeti se te njëjtat janë te bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori Z. Gj. M. nga Fsh G. K-Istog për periudhën kohore 04.03.2014 e gjerë më 31.12.2019, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1, te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për faktin se edhe pse debitori nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se ka bërë disa pagesa paushallë mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraparak apo në emër të faturave për muajt vijues, dhe se me vet faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventual te borxhit, këto pagesa nuk e ka bërë ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, konform nenit 368 te LMD-se. Njëkohësisht, ky është edhe qëndrim i Gjykatës Supreme te Kosovës, referuar vendimit (aktgjykimi Rev.nr.148/12, dt:09.09.2013).

Sa i përket borxhit për periudhën kohore 01.01.2020 e gjerë me 06.11.2021, gjykata, gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim te borxhit te kreditorit, ne raport me debitorin për këtë periudhe kohore, referuar nenit 360, par.2 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet qe afati i parashkrimit për çdo kërkesë te arritur gjate një viti, fillon te rrjedhe ne fundin e atij viti, e qe ne rastin konkret për te gjitha kërkesat e arritura ne vitin 2020, afati I parashkrimit ka filluar te rrjedh me 01.01.2021, dhe ne rastin konkret nuk kemi kalim te afatit te parashkrimi, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datë 07.12.2021, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, konform nenit 369 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Gjykata konform nenit 17 te LPP-së, përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore te LMD-së.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.2 dhe par.3, 37, 38, 69, 71 par.1.4 e 73 par.3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, lidhur me nenin 360 par.1 dhe 2, dhe 368, 369 dhe 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.58/2021, dt: 02.02.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.